



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisionieri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.4.2023

Nr: 366

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË DEMOKRATIKE DHE VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË
FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT VETËDEKLARUES Z. QERIM ISMAIL
ISMAILAJ, KANDIDAT PËR KRYETAR TË BASHKISË MALLAKASTËR I PROPOZUAR NGA
SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 15.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Kërkues: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa

Objekt: Shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për Kryetar Bashkie i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për Bashkinë Mallakastër.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11 të ligji nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Data: 15.4.2023 Nr: 366
Ora:11:00



Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për Kryetar të Bashkisë Mallakastër i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

V Ë R E J:

Në zbatim të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak.

Me vendim të KZAZ nr. 20 të datës 27.3. 2023, z. Qerim Ismail Ismailaj është regjistruar si kandidat për kryetar të Bashkisë Mallakastër, i mbështetur nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Për këtë kandidat në datën 1.4.2023, pranë KQZ-së është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili është regjistruar me nr. unik FR-PS-16657. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ-së, DPGJ informon se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Qerim Ismail Ismailaj, rezulton:

- Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij;
- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 "A jeni dënuar ndonjë here me vendim gjyqësor të formës së prerë", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO";
- Pyetjes 3 "A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një veprë penale?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO".

Në seancën e datës 13.4.2023 përfaqësuesi i Partisë Demokratike, z. Indrit Sefa ka ngritur pretendimin se kandidati për Kryetar Bashkie z. Qerim Ismailaj për Bashkinë Mallakastër, nuk duhet të dërgohet për verifikim të thelluar, por duhet të ndalohet të kandidojë pasi rezulton te jetë në kushtet e ndalimit për t'u zgjedhur dhe emëruar për funksione publike.

Në mbështetje të pretendimit të tij, përfaqësuesi i Partisë Demokratike z. Indrit Sefa ka paraqitur Vendimin nr. 11 datë 2.2.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar, e cila ka vendosur: 1. Deklarimin fajtor të z. Qerim Ismailaj, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimi i vulave, i stampave ose formularëve" parashikuar nga neni 190 paragrafi i parë i K.Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim; 2. Në aplikim të nenit 406 të K.P.Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin e të pandehurit me 4 muaj burgim; 3. Në aplikim të nenit 63 të K.Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim të pandehurit z. Qerim Ismailaj dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik për një kohë prej 40 orësh, e cila do të përmbushet brenda një afati 6 muajsh.

Në seancën e datës 14.4.2023 përfaqësuesi i Partisë Socialiste z. Eridjan Saliari ngriti pretendimin se z. Qerim Ismailaj e ka shlyer dënimin e dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar, e për këtë arsye nuk është në kushtet e ndalimit për t'u zgjedhur dhe emëruar në

funksione publike.

Në mbështetje të pretendimit të tij, përfaqësuesi i Partisë Socialiste z. Eridjan Saliani, depozitoi vendimin me datë 9.3.2023 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila ka vendosur: *“1. Të konsiderojë të kryer dënimin alternativ të dhënë me vendimin penal nr. 35/112 akti, datë 2.2.2023 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar për të pandehurin Qerim Ismailaj; 2. Me përfundimin e punës nga i pandehuri Qerim Ismailaj, dënimi konsiderohet i paqenë”*.

Përfaqësuesi z. Eridjan Saliani ka depozituar vërtetimin me nr. 195/3 datë 9.3.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dega Territoriale Fier, në të cilin specifikohet se z. Qerim Ismail Ismailaj ka kryer periudhën e dënimit alternativ prej 40 (dyzetë) orë pune në interes publik të vendosur me vendimin nr. 31/112, akti datë 2.2.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar.

Në vlerësim të dokumentacionit të mësipërm, si dhe bazuar në nenin 63 paragrafi i gjashtë i Kodit Penal çmohet se kandidati për Kryetar Bashkie z. Qerim Ismailaj nuk është në kushtet e ndalimit për t'u zgjedhur dhe emëruar në funksione publike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015.

Urdhërimi i paragrafit të parafundit të nenit 63 të Kodit Penal, që pas kryerjes së punës në interes publik, dënimi konsiderohet i paqenë, i adresohet çdo autoriteti shtetëror për sa duhet të ndikohet në marrëdhënien e ardhshme ligjore me shtetasin e dënuar. Urdhërimi i Kodit Penal për të MOS KONSIDERUAR, dënimet penale në rast alternativimi me orë pune, mbetet prioritar ndaj çdo ligji që nuk ka fuqinë e vetë Kodit.

I vetmi kontroll paraprak që mbetet për të realizuar, përpara detyrimit moskonsiderues, është kqyrja e vetë vendimit, kryerjes së orëve të punës, kohës së realizimit e verbal ekzekutimit. Çdo korrektesë në përmbajtjen e kohës së ekzekutimit, e dëshmuar me vërtetim të autoritetit përkatës, veçanërisht prokurorit kompetent për ekzekutimin, shuan çdo pengesë ligjore passjellëse të vetë dënimit fillestar (i konsideruar i pa qenë si dënim, pra nuk ekziston).

Ndaj kërkesa e subjektit zgjedhor Partia Demokratike për të ndaluar kandidimin e z. Qerim Ismailaj, si kandidat për kryetar të Bashkisë Mallakastër, nuk është e bazuar në ligj dhe duhet të rrëzohet.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formularin e vetëdeklarimit, KQZ çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi

zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Mospranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Partia Demokratike për mos lejimin e z. Qerim Ismailaj për të kandiduar si kandidat për kryetar në Bashkinë Mallakastër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar bashkie i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për Bashkinë Mallakastër dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 15.4.2023 Nr: 366
Ora:11:00



Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për Kryetar të Bashkisë Mallakastër i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.